



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2023:267682
Datë: 15.10.2024
Numri i dokumentit: 06301670

C.nr.2045/23

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtaren Fëllanza Knushaj dhe me bashkëpunëtoren profesionale Argjelina Prenku, duke vendosur në çështjen kontestimore të paditëses T.Llnga Gjakova, të cilin e përfaqëson i autorizuari Ylli Bokshi, avokat në Gjakovë, kundër të paditurës Komuna e Gjakovës – Drejtoria e Arsimit, të cilën me autorizim e përfaqëson e autorizuar Qëndresa Bytyqi Hoxha, për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit, vlera e kontestit 340.00 euro, jashtë seance me datë 15.10.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht e bazuar në ligj kërkesëpadia e paditësit T.Llnga Gjakova dhe DETYROHET e paditura Komuna e Gjakovës - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit të lartcekur, në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit, për periudhën kohore nga 01.11.2022 e deri me datë 21.11.2022, respektivisht për 11 ditë të pranisë në punë, të ia paguajë shumën prej 22.00.-€ (njëzet e dy euro), me kamatë ligjore prej 8%, e cila do të filloi të llogaritet nga data 27.11.2023 (datë e parashtrimit të padisë) deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit.

II. REFUZHET si e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit mbi shumën e aprovuar sikurse në dispozitivin nën I të këtij aktgjykimi e deri në shumën e kërkuar dhe atë në emër të shpenzimeve të ushqimit në shumën prej 318.00.-€.

III. DETYROHET e paditura Komuna e Gjakovës - Drejtoria e Arsimit, që në emër të shpenzimeve të procedurës, paditëses të ia paguaj shumën prej 98.00.-€ (nëntëdhjetë e tetë euro), në afat prej 7 ditëve, nga dita e marrjes së aktgjykimit, e nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

Paditësi T.Llnga Gjakova, në këtë gjykatë me datë 27.11.2023, përmes të autorizuarit të tij Ylli Bokshi, avokat në Gjakovë, ka ushtruar padi kundër të paditurës Komuna e Gjakovës – Drejtoria e Arsimit, për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit, duke theksuar se e njëjta është e punësuar si mësimdhënëse e historisë në Institucionin Arsimor – Gjimnazin “Hajdar Dushi” në Gjakovë, ku nga data 01.11.2022 deri me datë 21.11.2022 ka realizuar 11 ditë pune. Të njëjtës nuk i është kompensuar nga e paditura obligimi për ushqimin në punë, andaj ka paraqitur padi ku ka kërkuar nga gjykata që të detyrojë të paditurën që të bëjë pagesën e kompensimit për shujta për 11 ditë në shumë prej 340.00 euro, ka kërkuar kamatën ligjore si dhe shpenzimet procedurale.

E paditura Komuna e Gjakovës, përmes të autorizuarës së saj Qëndresa Bytyqi Hoxha, në këtë gjykatë ka parashtruar përgjigje në padi me datë 16.05.2024, ku ka theksuar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesë padinë si të pa bazuar me arsyetimin se paditëses nuk i takon ky kompensim sepse nuk është përcaktuar me kontratën e punës, e as me Ligjin e Punës numër 03/L-212, prandaj kërkesës së paditësve iu mungon baza juridike. Kontrata Kolektive në të cilën është thirrur paditësja nuk ka fuqi ligjore sepse është në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi. Kjo kontratë nuk është e nënshkruar nga Komuna e Gjakovës si autoritet i veçantë, respektivisht si njësi e vetëqeverisjes lokale si punëdhënës i vetëm i kësaj kategorie të punonjësve të arsimit. Sipas kontratave të punës parashihet për mësimdhënës që të i kenë 20 orë në javë si orë pune dhe 20 orë në javë si orë mësimi, e që të njëjtit nuk i përmbahen këtij orari. Tutje ka cituar dispozitën e nenit 46 par.2 të KKAK-së ku shprehimisht thotë se pagesa e tillë si për kompensimin e ushqimit bëhet brenda mundësive institucionale, ligjore dhe financiare, për çka ka konsideruar se nuk janë plotësuar kushtet e parapara në Kontratë sepse të paditurës nuk i janë ndarë mjetet financiare nga institucionet nënshkruese të Kontratës Kolektive për pagesën e shujtës. Po ashtu e njëjta është thirrur në parashkrim dhe në faktin se nuk janë shtjerrë të gjitha mjetet administrative dhe juridike sipas procedurës administrative të përcaktuar me nenin 78 par.1, 79 dhe 82 të Ligjit të Punës. Ka theksuar se ka indikacione që kemi të bëjmë me rast të gjykuar, ku ka kërkuar nga gjykata verifikimin e kësaj rrethane. Andaj, ka kërkuar nga gjykata që padinë dhe kërkesë padinë e paditëses ta refuzojë në tërësi si të pa bazuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 dhe 399 të LPK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet për dhënien e aktgjykimit jashtë seance dhe erdhi në përfundim se kërkesëpadija e paditëses është pjesërisht e themeltë dhe si e tillë pjesërisht u aprovua.

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura me padi dhe përgjigje në padi, gjykata ka gjetur se nga Kontrata e punës për paditësen e lëshuar nga Komuna e Gjakovës – Drejtoria e Arsimit, këtu e paditura, në versionin e fotokopjuar, vërtetohet fakti se paditësja e lartcekur është në marrëdhënie pune tek e paditura në Gjimnazin “Hajdar Dushi” në Gjakovë, si punëtor Tekniko shërbyes dhe se në periudhën prej datës 01.11.2022 e deri me datë 21.11.2022, paditësja ka punuar gjithsej 11 ditë pune, fakt i vërtetuar përmes Vërtetimit mbi ditët e prezencës në punë me numër 2394 i lëshuar nga drejtori i Gjimnazit “Hajdar Dushi” në Gjakovë me datë 23.11.2023.

Gjykata provave të lartcekura iu fali besimin e plotë ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre, duke u bazuar edhe në nenin 329 par.1 të LPK-së, i cili përcakton se *“Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”*.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), e nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 22.01.2021. Duke u nisur nga fakti se e paditura, paditëses nuk ia ka paguar shpenzimet e ushqimit të parapara me nenin 35 par.7 të KKAK, ku është përcaktuar se *“Të punësuarve iu njihet e drejta për ushqim gjatë punës për ditët e pranisë në punë, vlera e kompensimit të ushqimit për një ditë të pranisë në punë, është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënie primare të punës në institucionet arsimore. Punëdhënësi i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve përmes restaurantit apo kuzhinës, apo ndonjë forme tjetër nuk e ka obligim pagese (2 euro), të te punësuarve për ushqim për t'a bërë kompensimin”*. Në rastin konkret, gjykata ka vërtetuar se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar vetëm sa i përket periudhës kohore nga data 01.11.2022 deri me datë 21.11.2022, ashtu që bazuar në Vërtetimin mbi ditët e prezencës në punë me numër 2394 i lëshuar nga drejtori i Gjinnazit “Hajdar Dushi” në Gjakovë me datë 23.11.2023, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi gjatë kësaj periudhe kohore ka vijuar gjithsej 11 ditë, ashtu që gjykata pasi bëri përllogaritjen në atë mënyrë që ditët e pranisë në punë i ka shumëzuar me 2, ia njohi shumën si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata ka vlerësuar të gjitha pretendimet e përfaqësueses ligjore të të paditurës të dhëna në përgjigje në padi, të cilat i refuzoi për arsyet si në vijim:

Fillimisht, sa i përket pretendimit të të paditurës se rasti ka të bëjë me çështje të gjykuar, gjykata gjeti se një pretendim i tillë është i pabazuar kjo për faktin se pas shikimit të të gjitha çështjeve juridike kontestimore të iniciuara nga paditësja lidhur me kompensimin e shpenzimeve të ushqimit, ka rezultuar se në këtë gjykatë lidhur me këtë kërkesë për paditësen është vendosur vetëm sa i përket periudhës 01.07.2021 deri me 31.10.2022 dhe atë me Aktgjykimin C.nr.1676/22 i datës 27.06.2023, ndërsa periudha e kërkuar sipas padisë së datës 27.11.2023, konkretisht nga data 01.11.2022 deri me datë 21.11.2022, nuk përfshin periudhën e gjykuar me aktgjykimin e lartcekur, andaj nuk kemi të bëjmë me çështje të gjykuar.

Gjykata vlerësoi pretendimin e të paditurës në lidhje me mungesën e bazës ligjore të kërkesëpadiisë me arsyetimin se Ligji i Punës nuk e ka paraparë pagesën e kompensimit për shujta, mirëpo këtë pretendim e refuzoi për shkak se baza e kërkesëpadiisë rrjedh nga Kontrata Kolektive e Arsimit, e cila në nenin 2 par.1 ka përcaktuar se *“Dispozitat e kësaj Kontrate kolektive janë të zbatueshme për të gjithë të punësuarit në të gjitha institucionet publike dhe private të Arsimit Parauniversitar (parashkollor, fillor, të mesëm, të ulët dhe të mesëm të lartë, shkolla speciale e qendra të kompetencës) dhe institucionet e arsimit të lartë në mbarë territorin e Republikës së Kosovës, të cilët janë anëtarë të SBASHK-ut.”* Gjykata konsideron se kjo

kontratë është marrëveshje e cila bazohet në Ligjin e Punës numër 03/L-212 ku ndër të tjera ky ligj në nenin 90 par.5, ka përcaktuar se *“Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive”*. Andaj, për këtë arsye, gjykata konsideron se edhe pse Ligji i Punës specifikisht nuk e ka përcaktuar kompensimin për shujta, një gjë të tillë e ka paraparë Kontrata Kolektive e Arsimit, si marrëveshje kolektive në përputhje me Ligjin e Punës. Ndërsa sa i përket pretendimit se e paditura nuk është nënshkruese e kësaj kontrate, një pretendim të tillë e refuzoi për arsye se Kontrata Kolektive e Arsimit është e nënshkruar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, andaj prodhon efekt juridik ndaj punëdhënësve të cilët kanë të punësuar punëtorë që të drejtat e tyre burojnë nga kjo kontratë, në rastin konkret e paditura është punëdhënëse e paditëses dhe detyrohet për përmbushjen e detyrimeve që dalin nga kjo kontratë për paditësen.

Si pretendim tjetër të dhënë në përgjigje në padi, se në rastin në fjalë kemi parashkrim të kërkesës, gjykata një pretendim të tillë e refuzon si të pabazuar, për arsye se konform nenit 87 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, i njëjti ka përcaktuar se *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*, e që në rastin konkret paditësja ka kërkuar që të i kompensohen shpenzimet e ushqimit për periudhën kohore prej datës 01.11.2022 deri me datë 21.11.2022, ndërsa padinë e ka paraqitur me datë 27.11.2023, pra brenda afatit prej tre viteve nga kur ka lindur e drejta për kërkesën nga marrëdhënia e punës.

Gjykata analizoi edhe pretendimet e tjera të përfaqësueses ligjore të të paditurës dhe atë në lidhje me faktin se nuk janë shtjerrë të gjitha mundësitë ligjore në procedurë administrative për realizimin e kërkesës, mirëpo një pretendim të tillë e refuzoi pasi që gjykata nuk është e lidhur me mjetet administrative brenda institucionit përkatës kur vendos lidhur me kërkesën. Në rastin konkret, për të paditurën detyrimi për të kompensuar kompensimin në emër të ushqimit rrjedh nga Kontrata Kolektive e Arsimit dhe nuk duhet të jetë e lidhur me kërkesën e të punësuarit. Rrjedhimisht paditësja, si e punësuar në arsim, nuk ka qenë e detyruar që të bëjë kërkesë të veçantë për kompensim të shujtave, pasi të njëjtën punëdhënësi do të duhej të ia përmbushte në momentin që janë plotësuar kushtet për kompensimin e saj në përputhje me kontratën kolektive të lartcekur, prandaj meqë një detyrim i tillë nuk është përmbushur, ka lindur e drejta për të kërkuar kompensimin përmes rrugëve gjyqësore, siç kanë vepruar në rastin konkret paditësja.

Lartësia e kamatës së përcaktuar prej 8%, i referohet nenit 382 të LMD-së dhe kamata është llogaritur nga dita e parashtrimit të padisë.

Sa i përket pikës II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, përkatësisht refuzoi si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit në shumën prej 318.00 euro, për shkak se nga provat të cilat gjenden ne shkresat e lëndës përkatësisht nga vërtetimi i datës 23.11.2023, mbi ditët e pranisë në punë rezulton se paditësja për periudhën nga data 01.11.2022 deri me datën 21.11.2022 ka vijuar 11 ditë të pranisë në punë, ashtu që gjykata pasi bëri përlllogaritjen në atë mënyrë që ditët e pranisë në punë i ka shumëzuar me 2, që i bie në shumë prej 22.00 euro. Gjykata vlerëson se paditësi me asnjë provë nuk e ka provuar që vijuar me shumë ditë punë për periudhën kohore të kërkuar në

padi, siç parashihet me nenin 7 paragrafi 1 të LPK-së, ku parashihet se “ *Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova më të cilat konstatohen faktet e tilla.* ”

Andaj, nga këto arsye, gjykata vendosi si në të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke pasur parasysh se edhe në rastin konkret janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës të përcaktuara në nenin 399 të LPK-së, ku në paragrafin 1 të këtij neni është përcaktuar se “*Kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritore me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia*”, ndërsa në paragrafin 2 është paraparë se “*Kërkesëpadia është e pathemeltë, në vështrim të paragrafit 1 të këtij neni, po që se qartazi është në kundërtënie me faktet e treguara në padi, apo, po që se faktet mbi të cilat mbështetët kërkesëpadia qartazi janë në kundërtënie me provat të cilat i ka propozuar paditësi, apo me faktet që janë botërisht të ditura*”.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale si në pikën II të dispozitivit, gjykata e morri sipas nenit 449 dhe 452 par. 1 të LPK-së, me ç‘rast paditëses iu pranua shuma e shpenzimeve në vlerë prej 98.00.€. Lartësia e shpenzimeve të aprovuara i referohet shpenzimeve për pagesën e taksës gjyqësore në vlerë prej 20.00.-€ (e paraparë sipas Udhëzimit Administrativ Nr.01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore), si dhe për përpilimin e padisë shuma prej 78.00.-€, e paraparë sipas tarifës së Odës së Avokatëve të Kosovës Nr. Tarifor 6 dhe 17).

Prandaj, gjykata bazuar në arsyet e cekura më lartë, bazuar në nenin 143 lidhur me nenin 398 dhe 399 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

- Departamenti i Përgjithshëm -
C.nr.2045/23, datë 15.10.2024

Gj y q t a r j a,
Fëllanza Knushaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 7 ditëve, pas pranimit të tij, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.